



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e organizatës që ju drejtoni, në përgjigje të kërkesës tuaj, ardhur nëpërmjet postës elektronike, regjistruar me numër rendor 17, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 3381 Prot., datë 13.06.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 277, pika 5 parashikon se: *“Jo më vonë se 1 muaj nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sistemet aktuale të teknologjisë së informacionit, përfshirë edhe kontratat në fuqi për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e këtyre sistemeve, si dhe çdo dokument tjetër teknik ose juridik kalojnë në dorëzim dhe përgjegjësi të Këshillit nga drejtoria përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor bëhet palë në kontratat ekzistuese ex lege”.*

Referuar këtij kuadri ligjor, Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet aktit të dorëzimit me nr. 4871 prot., datë 21.06.2019 ka marrë në dorëzim të gjithë sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ku pjesë është dhe portali www.gjykata.gov.al, i cili është krijuar nga Ministria e Drejtësisë.

Lidhur me pyetjet tuaja se sa është në vlerë tenderi për zhvillimin e portalit të ri gjyqësor; cila është kompania fituese; nëse është bërë funksional portali i ri gjyqësor; cilat janë gjykatat me efikase në përdorimin e portalit të ri si dhe problemet e konstatuara ju sqarojmë se, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka ndërtuar një portal të ri por mirëmban portalin ekzistues të dorëzuar nga Ministria e Drejtësisë nga data 21.06.2019.

Gjithashtu, informojmë se në portalin e gjykatave (www.gjykata.gov.al), çdo gjykatë përditëson në hapësirën e dedikuar çdo informacion që përbën interes publik dhe siguron transparencë të veprimtarisë së punës që lidhen me listën e shortit, kalendarin e seancave gjyqësore, të dhënat për çështjet etj.

Gjykata e Shkallës së Parë për Juridiksionin e Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nuk bëjnë pjesë në portalin www.gjykata.gov.al, por kanë portalet e tyre që janë www.gjykatatirana.gov.al dhe www.gjp.gov.al.

Shërbimi i mirëmbajtjes dhe i përmirësimit të këtyre faqeve web (www.gjykatatirana.gov.al dhe www.gjp.gov.al) mbulohet nga vetë gjykatat.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, që nga marrja në dorëzim të portalit të gjykatave (www.gjykata.gov.al), ka kryer zhvillime informatike që lidhen me përmirësimin e punës dhe garantimin e transparencës konform ligjit.

Gjithashtu ju informojmë se, përditësimi i të dhënave për çështjet gjyqësore, përditësimi i listës së shortit dhe përditësimi i kalendarit të seancave kryhet në rrugë automatike, nëpërmjet një rrjeti të sigurt “Virtual Private Network” (VPN), nga serveri i gjykatës në drejtim të serverit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka zhvilluar mekanizma të cilat bëjnë kontrole automatike mbi transferimin ose jo të të dhënave më të fundit në portal. Ky mekanizëm evidenton rastet kur gjykata nuk ka transferuar materialin për shkak të mungesës së linjës së internetit dhe njofton nëpërmjet një emaili IT-në e gjykatës dhe Këshillin që të merren masa për transferimin e të dhënave.

Theksojmë se pasqyrimi i informacionit mbi çështjen, planifikimi i seancave dhe i vendimeve gjyqësore pasqyrohet në portal vetëm pasi sekretaria e gjykatës ka kryer veprimet në sistemin e menaxhimit të çështjeve. Në rastet kur sekretari gjyqësor nuk ka kryer veprime në sistemin e gjykatës, informacioni nuk publikohet.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!